

789

Në bazë të nenit 25 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM
PËR EMETIMIN E KARTËMONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 10 DENARË ME
KARAKTERISTIKA THEMELORE TË NDYSHUARA

1. Me këtë vendim emetohen kartëmonedhat me vlerë nominale 10 denarë me karakteristika themelore të ndryshuara.

2. Kartëmonedhat me vlerë nominale 10 denarë kanë karakteristikat themelore të përshkruara në Vendimin për emetimin dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 218/16) dhe Vendimin për ndryshimin e Vendimit për emetimin dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ 12/17), me këto ndryshime:

- Në Vendimin për emetimin dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 218/16) në nën pikën 3.1 paragrafi 3, shkurtesa: „НБРМ“ zëvendësohet me shkurtesën „НБРСМ“.

- Në paragrafin 11 fjalët: „Народна банка на Република Македонија“ zëvendësohen me fjalët: „Народна банка на Република Северна Македонија“.

- Në paragrafin 14 shkurtesa: „НБРМ“ zëvendësohet me shkurtesën: „НБРСМ“.

- Në paragrafin 16 fjalët: „Народна банка на Република Македонија“ zëvendësohen me fjalët: „Народна банка на Република Северна Македонија“.

- Në paragrafin 21 shkurtesa: „НБРМ“ zëvendësohet me shkurtesën: „НБРСМ“.

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Nr.V. 02-15/II-7/2019
28 shkurt viti 2019
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dr. Anita Angelovska-Bezhoska, d.v.